

VENDIM
Nr. 131, datë 10.8.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES SË
FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/5 prot., datë 5.8.2020, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, në sektorin e energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Në nenin 87, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se: ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;

- Këshilli i Ministrave, me VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016 ka vendosur “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike. Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”, ku parashikohet se deri në përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;

- me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 115, datë 8.7.2016, mbi përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, Bordi i ERE-s ka vendosur që: 1. të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016, deri në 31.12.2016. 2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit sipas parashikimeve të vendimit të Këshilli i Ministrave nr. 449, datë 15.6.2016;

- Në vijim për këtë vendimmarrje, Bordi i ERE-s është shprehur, me vendimin nr. 96, datë 4.7.2017, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, duke vendosur: 1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016.

- Për qëllime të përmbushjes së detyrimeve sa më sipër, është draftuar rregullorja e cila ka për objekt të saj, të caktojë procesin e përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit që i kërkohet të kryejë shërbimin e furnizimit në përputhje me nenin 87, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 449, datë 15.6.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”.

- Elementet që mbahen në konsideratë në hartimin e kësaj rregulloreje, janë parashikimet e nenit 87, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016.

- Sa u përket të drejtave dhe detyrimeve të të licencuarit të përzgjedhur si Furnizues i Mundësisë së Fundit dhe klientëve që përfitojnë këtë shërbim janë ato që parashikohen në rregullat për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike të miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti